

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit E.G. nga fshati ... komuna e Prizrenit, për rimbursim të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditurit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.11/08, të datës 24.02.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 21.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit E.G. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.11/08, i datës 24.02.2014, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.11/08, të datës 24.02.2014, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin E.G. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit që paditësit t'ia kompensoj shumën prej 13,679.00 euro, në emër të rimbursimit të dëmit për aksidentin e datës 12.11.2006, të gjitha me kamatë ligjore, duke filluar nga data 24.02.2014, e deri në pagesën definitive. Në pikën II të dispozitivit e ka obliguar të paditurin që shumën nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 68 euro, t'ia paguajë paditësit në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi i padituri në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e E.G.t nga fshati ..., komuna e Prizrenit, si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar ta prishë dhe lëndën ta kthejë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve (ish Fondi i Garancisë së Kosovës), me datë 08.01.2008, në Gjykatën Komunale në Prizren ka paraqitur padi për rimbursim dëmi, kundër të paditurit E.G. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri t'ia kompensoj shumën prej 13.679.00 €, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e datës 12.11.2016, në fshatin ..., komuna e Prizrenit, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor pas administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.11/08, të datës 24.02.2014, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se pas administrimit dhe vlerësimit të provave është vërtetuar se me datën 12.11.2006, rreth orës 17:00 në fshatin ... – Prizren i padituri E.G. ka qenë duke drejtuar automjetin e markës “Opel”, me targa XYZ-KS-XYZ, i cili ka qenë me afat të skaduar të sigurimit që nga data 22.12.2004 dhe me të arritur në hyrje në fshatin ..., për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes ndaj kushteve dhe rrethanave të rrugës, ka goditur me pjesën frontale të anës së djathtë, në pjesën e pasme biçikletën, i cili po ashtu ishte duke lëvizur në të njëjtin drejtim dhe pas shkaktimit të aksidentit, i njëjti largohet nga vendi i ngjarjes, ndërsa biçiklistin e lënduar disa kalimtar rasti e dërgojnë në Spitalin e Prizrenit, ku si pasojë e këtij aksidenti ka humbur jetën. Gjykata ka theksuar se të dëmtuarit – familja S.kanë parashtruar kërkesë për zhdëmtim ndaj këtu paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit – ish Fondit të Garancisë së Kosovës. Më tutje gjykata ka theksuar se nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 25.01.2007, është arritur marrëveshja në mes të Fondit të Garancisë të Kosovës dhe familjes S. për kompensimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 13,679.00 €, e cila shumë edhe iu është paguar të dëmtuarve.

Lidhur me bazën juridike ka vendosur në bazë të dispozitave të nenit 262, 277 paragrafi 1 të LMD-së dhe nenit 4.6 të rregullit 3 mbi ndryshimin e rregullit për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë të datës 25.06.2004, ndërsa për shpenzimet ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurit për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore në lidhje me thirrjen e të paditurit për seancën e shqyrtimit kryesor, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se i padituri është ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 24.02.2014 dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, andaj edhe në kuptim të dispozitës së nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, mbajtja e seancës në mungesë të të paditurit është veprim i ligjshëm dhe i drejtë pasi që në rastin konkret ishin plotësuar kushte për mbajtjen e seancës në mungesë.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitura nga i padituri sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk janë pranuar si të themelta për arsye se gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare si për bazën juridike të kërkesëpadisë ashtu edhe për lartësinë e saj. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar.

Me nenin 1.7 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut nr. AI/2001/2 (askohe në fuqi), është paraparë se, ndër të tjera, *“mbulesa siguruese përjashtohet (nuk vie në konsiderim) në rastet kur vozitësi nuk posedon të drejtën për vozitje. Po ashtu sipas rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësive të datës 25 Qershor 2004, përkatësisht nenit 4.6 të tij, del se Fondi i Garancisë së Kosovës për Sigurime të Detyruara në Prishtinë (GFK - tani Byroja Kosovare e Sigurimeve), është i obliguar që këtë dëmin t’ia kompenzoj të dëmtuarit dhe të njëjtin ta rimburoj nga shkaktari i aksidentit.*

Gjykata e Apelit, e ka pranuar në tërësi përfundimin e shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë, ngase edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë në këtë çështje juridike kontestuese. Në këtë kontekst nuk janë pranuar pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të se drejtës materiale, pasi që nga gjendja faktike e konstatuar e cila është kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka rezultuar se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, pasi që me dispozitën e nenit 262 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore (LMD i vitit 1978) përcaktohet se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Lidhur me vendosjen për shpenzimet e procedurës Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosë për shpenzimet e procedurës duke e aplikuar dispozitën e 452 paragrafi 1 i LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1265/14, me datën 21.09.2018

Kryetari i kolegjit – Gjyqtari,
Valon Totaj